



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 105-Mars 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>





Përmbajtja:

Kryetari Kilaj priti zyrtarët e lartë të UN-HBITAT në Kosovë.....	3
Për nder të “Epopëja e UÇK-së”, KK mbajti mbledhje solemne si dhe u bën homazhe te varret e dëshmorëve	4
U shënuar 7 Marsi, Dita e Mësuesit	6
Shqetësuese paraqitet gjetja e lëndëve narkotike në afërsi të shkollës	7
U mbajt mbledhja e Këshillit të Drejtorëve	9
Ushtrimi fushor i FSK-së “Shqiponja 1”, do të mbahet edhe në territorin e Malishevës	9
Mbahet punëtorja “ Ngritja e Kapaciteteve të Zyrtarëve për Informim Publik dhe Teknologji Informative për të rritur Transparencën Komunale”	10
Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve	11
Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e XIX-të.....	11
Këshilli i Drejtorëve mbajti mbledhjen e rregullt.....	13
Nënshkruhen marrëveshje mbi menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësve	13
Nënkryetari Mazreku priti komandantin e kontingjentit turk të KFOR-it.....	14
Kryetari derën hapur për qytetar.....	15
Kontrollohen subjektet afariste për respektim të orarit të punës	16
Mbledhja e KK-së do të vazhdoj me 2 prill	16



Kryetari Kilaj priti zyrtarët e lartë të UN-HBITAT në Kosovë

Malishevë, 1 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur përfaqësuesit e UN-HABITAT-it në Kosovë, znj. Krystyna Galezia dhe Peter Engstrom, të cilët janë njoftuar me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, që mbështetet nga vet UN-HABITAT-i.

“Hartimi i këtij plani, nuk vihet në dyshim, por sfida është implementimi i tij për zhvillimin e rural”, tha kryetari Kilaj, duke njoftuar zyrtarët e UN-HABITAT-it. “Papunësia dhe mbrojtja e mjedisit janë dy problemet më të mëdha që kemi si komunë”, u shpreh më tej z. Kilaj. “Ne jemi një region bujqësor dhe këtu edhe është mundësia më e madhe për hapjen e vendeve të reja punës, pastaj janë mineralet, që është një mundësi tjetër për zhvillim ekonomik”, ka vazhduar Kilaj, duke treguar fushat ku mund të orientohet edhe plani për zhvillimin ekonomik.

“Mundësi tjetër është edhe zhvillimi i turizmit në fshatra, siç janë pishinat në Banjë dhe Shpella e Mermertë në Panorc, që pritet të hapet këtë vit për vizitor. “Mosha e re, është fuqia kryesore e jona, për çka e kemi edhe shkollën profesionale (Qendra e Kompetencës), përmes së cilës, përgatisim kuadro me përgatitje të mesme profesionale në disa fusha”, tha kryetari Kilaj, duke sqaruar edhe orientimin e komunës në përgatitjen e kuadrit profesional.

Ndërsa në interesimin e përgjegjësve të UN-HABITAT-it, për rëndësinë e ndërtimit të autostradës, kryetari Kilaj, tha se “ndërtimi i saj, padyshim që ka ndikim edhe në zhvillimin ekonomik”.



Për nder të “Epopeja e UÇK-së”, KK mbajti mbledhje solemne si dhe u bën homazhe te varret e dëshmorëve

Malishevë, 6 mars

Me rastin e shënimit të “Epopeja e UÇK-së”, me ftesë të Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, sot, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur një seancë solemne, si dhe janë bërë nderime dhe homazhe, pran shtatores së Komandantit Legjendar të UÇK-së Adem Jashari në Malishevë, homazhe në varrezat e Familjes Jashari në Prekaz, varrezave të dëshmorëve në Kleçke dhe Malishevë.



Në seancën solemne, fjalë rasti ka mbajtur Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, si dhe përfaqësues të partive politike dhe të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së.



Në këtë mbledhje, mori pjesë edhe zëvendësministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Fatmir Shurdhaj.

Në kuadër të shënimit të Ditëve të Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të





Kosovës, janë mbajtur edhe një varg aktiviteteve kulturore dhe sportive, ndërsa aktivitetet do të përmbillen nesër me ndezjen e zjarreve.

Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, i mbajtur në seancën solemne:

Të respektuara Familje të Dëshmorëve, Invalid e Veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar anëtarë të Kuvendit, mysafir dhe pjesëmarrës të kësaj mbledhje solemne;

Edhe sivjet, 14 vjet pas Epopesë së lavdishme të UÇK-së, po përkujtojmë luftën dhe rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jasharit dhe Jasharajve të tjerë të cilët iu kundërvunë një makinerie gjakatare serbe për të mbetur përjetësisht në panteonin e pavdekësisë.

Jo rastësisht, Epopeja e UÇK-së filloj në zemrën e qëndresës shqiptare, në Prekazin heroik të Ahmet Delisë, të Tahir Mehës e të Adem Jasharit, në Drenicën e Azem e Shotë Galicës të Fehmi e Xhevë Lladrovci e shumë heronjve të tjerë për tu zgjeruar pastaj fronti i luftës dhe qëndresës në gjithë Kosovën dhe trojet shqiptare.

Kjo luftë e drejtë e UÇK-së, synim kishte përfundimin e një përpjekje shekullore të shqiptarëve kundër shfarosjes dhe fshirjes nga harta që ishte synim i hordhive serbo-sllave që nga Stefan Dushani, Karagjorgjeviqët e gjere te ato të Millosheviqëve por populli ynë u bëri ballë tërë këtyre invaduesve, duke dalë pas çdo lufte më i bashkuar, më i përtërirë dhe më i vendosur për të mos ulur kokën kurrë përpara askujt.

Të nderuar pjesëmarrës;

Malisheva në këtë luftë titanike për liri dhe shtet, ishte ndër rajonet e para që ju përgjigj kushtimit të Adem Jasharit për liri.

Mijëra djem të këtij regjioni, pa hezituar u rreshtuan në radhët e UÇK-së, ju bashkuan luftës për liri dhe pavarësi, amanet ky i brezave të tërë.

Njësitët “Lumi” dhe “Çeliku” që ishin bërthama të Brigadave 121 dhe 122 të UÇK-së, për të mbrojtur nderin e luftës së komandantit Legjenda Adem Jashari, zhvilluan qindra beteja kundër forcave të armikut në Malishevë dhe fshatrat e saja si në Balincë, Mleçan, Bubavec, Dragobil, Bellanicë, Lladroc dhe fshatra



të tjera të kësaj komune të cilat u bënë vend i qëndresës në luftën më të lavdishme të shqiptarëve për liri.

Sot kur po përkujtojmë 14vjetorin e Epopesë së UÇK-së, me respekt dhe krenari kujtojmë 70 dëshmorët që Komuna e Malishevës i dha Lirisë së Kosovës, kujtojmë të gjithë ata dëshmorë si Imer Krasniqin, Ibrahim Mazrekun, Hamdi e Habib Berishën, Habib Zogajn Ibrahim Morinën e deri te dëshmorët Agim Elshani, Visar Krasniqi, Labinot Krasniqi e Hilmi Hoti të cilët ranë në trojet tjera shqiptare për të mos vdekur kurrë.

Të nderuar të pranishëm;

Datat e lavdishme të Epopesë së UÇK-së, për ne në Malishevë, janë edhe një motivim më shumë që të ecim më tej në krijimin e një jete më të mirë për qytetarin tonë që ishte synim i luftës për liri dhe amanet i dëshmorëve.

Rroftë Epopeja e lavdishme e UÇK-së

I përjetshëm qoftë kujtimi për Komandantin Legjendar Adem Jashari, për Familjen Jashari dhe të gjithë dëshmorët e Kosovës.

Lavdi...

U shënua 7 Marsi, Dita e Mësuesit

Malishevë, 7 mars

Me aktivitete të shumta, sot në Komunën e Malishevës, është shënuar 7 Mars”, Dita e Mësuesit. Aktiviteti qendror, është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ku edhe janë shpallur mësuesit më të mirë për këtë vit shkollor, ndërsa janë nderuar edhe veteranët e arsimit.

“Ky vit është i veçantë, pasi shënojmë 125 vjetorin hapjes së shkollës së parë shqipe, në Korçë”, tha drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim (DAE), z.Isuf Morina, i cili në mënyrë kronologjike paraqiti zhvillimin e arsimit në trojet shqiptare në përgjithësi dhe në veçanti në Malishevë.



Ndërsa, në emër të Komunës së Malishevës, të gjithë arsimtarët dhe veteranët e arsimit, i ka përshëndetur nënkryetari z.Rexhep Mazreku.

Pasi shkollat kishin përzgjedhur arsimtarët më të mirë, drejtoria për Arsim dhe Edukim, ka zgjedhur më të mirët në ciklet e arsimit para fillor, fillor dhe ciklit të mesëm të ulët. Shqerie Shurdhaj, u shpall mësuesja më e mirë në ciklin para fillor, kurse në ciklin fillor, më e mira u shpall Zymrie Hoti. Për ciklin e



arsimit të mesëm të ultë, mësuesi i mirë u shpall Bashkim Kastrati, për sukseset e treguara në disa gara dhe konkurse në nivel vendi, në mesin e tyre edhe vendi i parë në garën e Zyrës Ndërlidhëse të Këshillit të Evropës, "Play for all".

Ndërsa, në ciklin e nivelit të mesëm të lartë, vet shkollat e këtij niveli kanë shpallur arsimtarët më të mirë.

Në këtë aktivitet, u shpallën edhe më të mirët në garat tradicionale të recitimit, për të gjitha ciklet e arsimit në nivel komunal, ku më të mirëve, u janë dhënë edhe shpërblime.

Nga mbledhja e KKS-së

Shqetësuese paraqitet gjetja e lëndëve narkotike në afërsi të shkollës

Malishevë, 9 mars

Në mbledhjen e sotme të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, shqetësues është paraqitur gjetja e lëndëve narkotike tek disa persona, në një lokal në afërsi të shkollës, i cili frekuentohet shumë nga nxënësit.

Kjo është raportuar nga ana e policisë, që edhe janë anëtar të këtij këshilli. Sipas u.d. të komandant i Policisë në Malishevë, z. Bekim Begaj "me 17 shkurt 2012, tek disa persona të cilët kanë qenë në një lokal, në afërsi të gjimnazit 'Abdyl Frashëri', në qytetin e Malishevës, janë gjetur lëndë narkotike,



ndërkohë që shqetësim paraqitet fakti, se ai lokal, frekuentohet shumë nga nxënësit e këtij gjimnazi”. Bastisja e personave është bërë, pas një zënke që ka ndodhur në mes tyre. Si vazhdimësi e këtij rasti, të nesërmen në një lokacion tjetër, policia ka arritur të gjej dhe të konfiskoj rreth 1 kg lëndë narkotike, ndërkohë janë arrestuar dy persona, të cilët janë dërguar në paraburgim për 30 ditë. Sipas z. Begaj, policia ka kryer punën e vet, dhe lënda është dorëzuar në gjykatë.

Lidhur me këtë rast, kanë shprehur shqetësim të gjithë anëtarët e KKSB-së, ndërkohë që është kërkuar një mobilizim dhe bashkëpunim edhe më i madh, për ta izoluar rastin.

Çështje tjetër e raportuar në këtë takim, ishte edhe ai në lidhje me intervenimin dhe daljen në ndihmë qytetarëve të komunës së Malishevës, në kohën e të reshurave të mëdha të borës. Nga të gjithë të pranishmit u raportua për angazhimin maksimal të instancave kompetente, përfshirë këtu, drejtoritë komunale, në krye me kryetarin e komunës, z. Isni Kilaj, trupat e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), zv.ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Fatmir Shurdhaj, policinë, etj., të cilët kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, si në ndihmë për hapjen e rrugëve, ashtu edhe në ndihmë me gjëra ushqimore.

KKSB, përbëhet nga kryetari i Komunë, zv.kryetari, drejtori i Drejtorisë i Mbrojtje dhe Shpëtim, përfaqësues nga Policia e Kosovës, përfaqësues të FSK-së, HANDIKOS, Qendra Rinore, Bashkësia Islame, Radio Malisheva, Shoqata e Veteranëve të Luftës (SHVL), përfaqësues i Komunitetit pakicë, Komunitetit të Bizneseve, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe përfaqësues të Ekipeve Vepruese të Sigurisë në Bashkësi (EVSb).

Në fund të takimit, OSBE, ka shpërndarë raportin “ Reagimet komunale ndaj incidenteve të sigurisë që preknin komunitetet e Kosovës dhe roli i Këshillave Komunalë për Siguri në Bashkësi”.

Sipas këtij raport, regjioni i Prizrenit, ku hynë edhe komuna e Malishevës, është ndër regionet më të qeta, ndërsa në fund janë edhe disa rekomandime për komunat, në rast se ato nuk kanë të formuara këto këshilla, ti formojnë ato sa më parë, etj.



U mbajt mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 12 mars

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka mbajtur sot, mbledhjen e rregullt të saj, ku janë diskutuar një varg çështjesh, që lidhen me punën e Qeverisë Komunale, ndërsa vëmendje e veçantë iu kushtua, hartimit të projekteve për këtë vit.

Kryetari Kilaj, ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse, angazhim në hartimin e projekteve, për të aplikuar me kohë në ministritë përkatëse. “Këtë vit do të implementohet projekti për fuqizimin e ujësjellësit në Banjë dhe ndërtimi i një nënstacioni të ujësjellësit për fshatin Carrallukë”, njoftoi kryetari Kilaj.

Po ashtu në këtë mbledhje, Këshilli i Drejtorëve mori vendim, që ti drejtohet Asamblesë Komunale, me kërkesën për caktimin e hapësirës për ndërtimin e Muzeut të Qytetit dhe Sahat Kullës.

Kryetari i Komunës, ka kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të angazhohet më shumë në përkujdesjen e parkut dhe hapësirës përreth liqenit “Mirusha”.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, z.Esat Paçarizi, ka njoftuar për ecurinë e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, me UN-HABITAT-in.

Ushtrimi fushor i FSK-së “Shqiponja 1”, do të mbahet edhe në territorin e Malishevës

Malishevë, 12 mars

Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot, zyrtarët e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, me të cilët ka nënshkruar një marrëveshje për mbajtjen e ushtrimit fushor të FSK-së, “Shqiponja 1” edhe në territorin e komunës së Malishevës.



Marrëveshja është nënshkruar nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj dhe z.Hajrush Kurtaj, Drejtor i Departamentit Civil-Ushtarak në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryetari Kilaj, pasi ju ka uruar sukses në mbajtjen e këtij ushtrimi, ka ofruar mbështetje institucionale të Komunës së Malishevës, për mbajtjen e këtij ushtrimi.

Për formën e organizimit të këtij ushtrimi dhe rëndësinë e tij, ka njoftuar, Shefja e Departamentit Civil-Ushtarak në Komandën e Forcave Tokësore, major Arife Halili.

Në këtë takim u fol edhe për aplikimin për pjesëtarë rezervë të FSK-së. Me këtë rast, zyrtari në Departamentin Civil-Ushtarak në MFSK, z.Agron Durmishi, falënderoi komunën për mbështetjen dhe ofrimin e hapësirës për MFSK-në në pranimin e aplikacioneve.

Mbahet punëtorja “ Ngritja e Kapaciteteve të Zyrtarëve për Informim Publik dhe Teknologji Informative për të rritur Transparencën Komunale”

Malishevë, 17 mars

Me organizimin dhe financimin e USAID-it, përmes projektit DEMI, Komuna e Malishevës dhe disa komuna të tjera të Republikës së Kosovës, që janë përfituese të këtij projekti, është mbajtur punëtori dy ditore në





Prevallë, me temën “ Ngritja e Kapaciteteve të Zyrtarëve për Informim Publik dhe Teknologji Informative për të rritur Transparencën Komunale”. Të pranishëm në këtë punëtori ishin përfaqësues të zyrave për informim publik dhe ata që kanë të bëjnë me teknologji informative (IT).

Me këtë rast, Agron Bajrami kryeredaktor i gazetës së e përditshme “ Koha Ditore”, ka shpjeguar për raportimin e çështjeve së Qeverisë Lokale (si t’i bëjmë lajmet më tërheqëse), duke shtuar se roli i zyrtarit për marrëdhënie me publikun është të krijoj urë lidhëse mes Kryetarit të Komunës dhe strukturave komunale me gazetarët, dhe me publikun në përgjithësi .

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 19 mars

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, u diskutuan disa çështje, në mesin e të cilave edhe mirëmbajtja e parqeve, në vendet publike të territorit të komunës së Malishevës.

Kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, ka kërkuar “që tash me fillim të pranverës, duhet shtuar kujdes në mirëmbajtjen e parqeve që ndërlidhet me përkujdesjen e ambientit, meqë edhe ashtu datën 24 maj Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka shpallur si fushatë ‘Të pastrojmë Kosovën’”.

Çështje tjetër që u diskutua ishte edhe ajo e furnizimit me ujë (nga ujësjellësi), e që sipas z. Nijazi Bytyçi, menaxher i Njesisë së Ujësjellësit në Malishevë, i cili ishte i pranishëm në këtë mbledhje, furnizimi me ujë për qytetarët është 24 orë pa ndërprerë.

Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e XIX-të

Malishevë, 20 mars

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot, mbledhjen e nëntëmbëdhjetë të rregullt (të tretën për këtë vit), ku janë shqyrtuar dhe dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale.



Pas shqyrtimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, KPF, ka shqyrtuar tri kërkesa të Kryetarit të Komunës, z. Isni Kilaj. E para ka të bëjë me formimin e këshillit të ekspertëve për planifikim për Komunën e Malishevës, pastaj kërkesa për harmonizimin e planit zhvillimor urban dhe ajo për hartimin e planit zhvillimor të Komunës së Malishevës.

Të tri kërkesat, pasi janë shqyrtuar, janë rekomanduar për në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale.

Në fund të kësaj mbledhje janë shqyrtuar edhe kërkesa të tjera, të drejtuara nga ana e qytetarëve për Komitetin për Politikë dhe Financa, ndërkohë që vendimi për disa ka rezultuar pozitiv e për disa negativ, varësisht prej rasteve.

Ndërkaq, Ramadan Klisurica Specialist për Kuvende Komunale nga ky projekt , ka shpjeguar edhe për ngjarjet komunale që duhet të raportohen.

Punëtorja ka vazhduar me Dizajnin e Buletinit komunal, (për ato komuna që nuk kanë ende buletin), përmes znj. Zana Budima, specialist për komunikim në DEMI, e cila ka bërë prezantimin mbi dizajnin e Buletinit Komunal.

Ndërsa, Flamur Mripa, konsulent për teknologji informative në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka shpjeguar për objektivat strategjike e-Qeverisje / e-Administratë, m-Shërbime në funksion të avancimit të proceseve të punës në MAPL dhe komuna me qëllim të ofrimit të shërbimeve efikase për qytetarët, bizneset dhe Qeverinë etj. Me këtë rast edhe Fidan Ferizi, administrator për teknologji informative, DataProgNet, ka treguar për mirëmbajtje dhe freskimin e ueb faqeve komunale.

Në fund të kësaj punëtorie, është organizuar punë në grupe, kryesisht për çështjet e cekura më lart, për ç'gjë znj. Melihate Limani, eksperte e lartë për pjesëmarrjen e qytetarëve, DEMI, ka treguar për përgatitjen e planit dhe shpërndarjen e buletinit komunal.



Këshilli i Drejtorëve mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 26 mars

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, ku janë trajtuar disa çështje, që kanë të bëjnë me punët e qeverinë komunale, në veçanti hartimi i projekteve me rëndësi gjatë këtij viti.

Me këtë rast, kryetari Kilaj, kërkoi angazhim më të madh nga ana e drejtorive, për hartimin e projekteve, në mënyrë që të aplikohet me kohë në ministrinë përkatëse dhe donatorët e ndryshëm, me qëllim realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit.

Në mbledhjen e sotme, u diskutua edhe për mirëmbajtjen e ambientit dhe përgatitjeve tjera, për shënimin e 1 Prillit, Ditës së Ambientit.

Në mes përfaqësuesve të HIDROREGJIONIT, komunës dhe të fshatrave Bardh e Ngucat

Nënshkruhen marrëveshje mbi menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësve

Malishevë, 26 mars

Kryetari e komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot në takim përfaqësues të HIDROREGJIONIT, dhe të fshatrave Ngucat e Bardh, me ç'rast janë nënshkruar marrëveshjet mbi menaxhimin e ujësjellësit për këto dy fshatra, nga ana e HIDROREGJIONIT.

“Komuna e Malishevës ia dorëzon në menaxhim



dhe mirëmbajtje sistemin e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura-kanalizimit në fshatin Bardh/Ngucat, të ndërtuara në pajtim me standardet teknike për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura të caktuara nga Zyra Rregullative për ujë dhe mbeturina K.R.U. 'HIDROREGJIONI jugor' Sh. A. me seli në Prizren si kompani e licencuar nga ZRRUM-i për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit", kështu thuhet në nenin 1 të marrëveshjeve (ngase për të dy fshatrat janë marrëveshje të ndara) .

Marrëveshjet janë nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të HIDROREGJIONIT, z. Liman Gashi, kryetarit të Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, dhe përfaqësuesve të fshatrave Bardh e Ngucat, z. Bedri Hoxha, përkatësisht z. Rexhep Krasniqi.

Vlen të përmendet se ujësjellësi i Bardhit është ndërtuar nga donacionet e Komunës së Malishevës dhe kontributit të vet fshatarëve, ndërsa ai i Ngucatit është ndërtuar nga donacionet e Organizatës humanitare "ALISEI" nga Italia, por gjithashtu edhe me kontributin e vet banorëve të fshatit.

Nënkryetari Mazreku priti komandantin e kontingjentit turk të KFOR-it

Malishevë, 27 mars



Nënkryetari i Komunës së Malishevës, z. Rexhep Mazreku, ka pritur sot në takim përshëndetës, komandantin e kontingjentit turk të KFOR-it në Kosovë, kolonelin Çelik, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin e institucionit të komunës dhe KFOR-it.

Nënkryetari Mazreku, e vlerësoi lartë bashkëpunimin mes komunës dhe KFOR-it në përgjithësi, si dhe me kontingjentin turk në veçanti. Me këtë rast falënderoi KFOR-in për bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë. "Ne ju falënderojmë për kontributin e dhënë që nga bombardimet e NATO-s, në vitin 1999 dhe për ndihmën tuaj në zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës dhe të Malishevës në veçanti", tha midis



tjerash nënkryetari Mazreku, i cili e informoi komandantin e KFOR-it turk, edhe për zhvillimet e përgjithshme në komunën e Malishevës dhe problemet me të cilat ballafaqohet komuna. “Papunësia është problemi kryesor dhe është pasojë e asaj që Malisheva nuk ka trashëguar asgjë nga e kaluara”, tha Mazreku.

Ndërsa koloneli Çelik, falënderoi komunën për bashkëpunimin e mirë, që nga viti 1999 e deri më sot. “NATO gjithmonë është në anën e atyre që janë të shtypur padrejtësisht, ashtu siç ka qenë populli i Kosovës, dhe që nga viti 1999, ne jemi këtu, duke u kujdesur për sigurinë dhe paqen për popullin e Kosovës”, tha koloneli Çelik. “Edhe Turqia ka ndihmuar dhe ka dhënë kontributin e saj në këtë drejtim, por shtetin turk e lidhin shumë gjëra me popullin e Kosovës, pasi në Turqi jetojnë një numër i madh i shqiptarëve nga Kosova”, tha koloneli Çelik, komandant i kontingjentit turk të KFOR-it në Kosovë.

Nënkryetari Mazreku dhe koloneli Çelik, vlerësuan lartë edhe bashkëpunimin me njësinë e LMT-së në Malishevë.

Kryetari derën hapur për qytetar

Malishevë, 29 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, sot ka mbajtur derën hapur për qytetarët, nga ora 10-12, disa nga ta edhe në emër të fshatrave, ku është njohur me problemet e tyre dhe në të njëjtën kohë, duke ju ofruar mbështetje apo udhëzime për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Në shumicën e rasteve qytetarët kanë paraqitur para kryetarit, problemet e tyre, kryesisht sociale, siç janë banimi, kërkesa për ndihmë sociale, si dhe probleme tjera, dhe për të gjitha këto, kanë marrë përgjigje nga ana e Kryetarit të Komunës, ose udhëzime për mënyrën e ndjekjes së procedurave të caktuara.

Po ashtu, edhe përfaqësuesve (kryetarëve) të fshatrave, të cilët kanë paraqitur problemet e komunitetit, e që shumica prej tyre, kishin të bëjnë me problemet me rrjet të kanalizimeve, kryetari Kilaj, ka sqaruar



se këtë vit do të ndërtohen kanalizimet, për të gjitha vendbanimet të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin primar dhe përfundimisht, do të zgjidhet ky problem.

Kontrollohen subjektet afariste për respektim të orarit të punës

Malishevë, 29 mars

Drejtoria e Inspektoratit (DI) e Komunës së Malishevës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë ndërmarr një aksion për kontrollimin e subjekteve afariste në lidhje me faktin se sa këto subjekte, janë duke e zbatuar rregulloren për respektimin e orarit të punës.

“Drejtoria e Inspektoratit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Malishevë, këto dy ditë ka marrë aksion për kontrollimin e subjekteve afariste në tërë territorin e Komunës së Malishevës. Ky kontrollim ka të bëjë me faktin se sa këto subjekte afariste e respektojnë rregulloren që ka të bëjë me orarin e punës”, kështu ka bërë të ditur drejtori i DI-së, z. Ismet Kafexholli. Bëhet e ditur se në tri lokale është vërejtur mos respektim i orarit të punës, me ç’rast inspektorati komunal ka dhënë vërejtjet e fundit. Në këtë kontekst, janë kontrolluar edhe disa lokale “lojëra fati”. Gjithsej janë inspektuar pesëmbëdhjetë subjekte afariste përfshirë këtu edhe lokale shërbyese/ hoteliere. Në këto të fundit (lokale hoteliere), është inspektuar së bashku me inspektorët sanitar regional, prej nga janë marrë njëmbëdhjetë mostra për analiza.

Vlen të theksohet se ky inspektim është bërë në orët e vona të natës së 27 dhe 28 marsit. Ky aksion, sipas Drejtorisë së Inspektoratit, do të vazhdojnë edhe më tutje.

Mbledhja e KK-së do të vazhdoj me 2 prill



Malishevë, 30 dhjetor

Pas miratimit të rendit të ditës, me shumicë votash, dhe më pas, pas lëshimit të mbledhjes, nga një pjesë e këshilltarëve të asamblesë, kryesuesi i KK të Malishevë, z.Ragip Begaj, për mungesë kuorumi, ka ndërprerë seancën e sotme (të XXV), dhe ka njoftuar se e njëjta do të vazhdoj të hënë, me 2 prill, me fillim në ora 10:00.

Këshilltarët e grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), kanë lëshuar takimin për shkak se nuk është miratuar kërkesa e tyre për shtyrjen e pikës katër të rendit të ditës, që kishte të bënte me shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës nr. 01/373 datë, 16.03.2012 për harmonizimin e planit zhvillimor urban, Malisheva 2004 - 2014 me Ligjin për planifikimin Hapësinor të Republikës së Kosovës, me arsyetimin e mungesës së materialit, të cilëve iu është bashkuar edhe njëri nga këshilltarët e AAK.

Më pas në mungesë të kuorunit, mbledhja u shty për ditën e hënë.